

Punëtorëve u duhet një pagë për të jetuar

FASHION
CHECKER

Clean
Clothes
Campaign

Clean Clothes Campaign është një rrjet global i dedikuar për përmirësimin e kushteve të punës dhe fuqizimin e punëtorëve në industrinë tekstile dhe atë të veshjeve sportive. Që prej vitit 1989, CCC ka punuar për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të punëtorëve. Ne edukojmë dhe mobilizojmë konsumatorët, llojmë pranë kompanive dhe qeverive dhe u ofrojmë punëtorëve mbështetje të drejtpërdrejtë dhe solidaritet të plotë ndërsa ata luftojnë për të drejtat e tyre dhe kërkojnë kushte më të mira pune. Fushata e Clean Clothes Campaign bashkon sindikatat dhe OJQ-të që mbulojnë një spektër të gjerë perspektivash dhe interesash, siç janë të drejtat e grave, mbrojtja e konsumatorit dhe ulja e varfërisë. Si një rrjet bazë i qindra organizatave dhe sindikatave, si në prodhimin e veshjeve ashtu edhe në tregjet e konsumit, ne mund të identifikojmë problemet dhe objektivat lokale dhe t'i transformojmë ato në aksione globale. Ne zhvillojmë strategji fushatash për të mbështetur punëtorët në arritjen e qëllimeve të tyre. Ne gjithashtu bashkëpunojmë gjerësisht me fushata të ngjashme për të drejtat në punë.

Që nga viti 2014 ne kemi qenë duke punuar në zhvillimin e një metodologjie për një pikë referimi ndërkufitare për pagën e jetesës për vendet evropiane të prodhimit të veshjeve. Pas shumë diskutimesh, ne zhvilluam konceptin e Pagës Evropiane Dysheme.

E drejta e njeriut për pagë të denjë sipas të drejtës ndërkombëtare publike

E drejta e njeriut për pagë të denjë është një e drejtë e vendosur nga Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Në kontekstin evropian, Karta Evropiane Sociale e Këshillit të Evropës (ESC 1965) dhe versioni i saj i rishikuar i vitit 1999 e kodifikojnë të drejtën për pagën e jetesës në nenin 4, nr. 1: "të njohin të drejtën e punëtorëve për një shpërblim të tillë që u jep atyre dhe familjeve të tyre një standard të denjë jetese". ESC njihet në të gjithë Evropën dhe jo vetëm në shtetet anëtare të BE-së.

PAGË JETESE

Për t'u përfshirë, kontaktoni organizatën tuaj kombëtare të Clean Clothes Campaign



Pse fokusohemi te paga e jeteses?

Pagesa e varfërisë përbën një realitet të turpshëm, nëse shohim fitimet e nxjerra nga markat dhe shitësit me pakicë në zinxhirin e furnizimit të veshjeve. Ata përfitojnë nga kontrolli i dyfishtë që kanë mbi tregjet ndërkombëtare të konsumatorëve dhe mbi zonat e prodhimit me kosto të ulët në Jugun Global dhe në 'Lindjen Globale'.

Disa shitës me pakicë dhe disa marka e pranojnë parimisht të drejtën për një pagë jetese në kodet e tyre vullnetare; megjithatë, në praktikë ata shpesh, thjesht monitorojnë respektimin nga ana e furnitorëve të pagës minimale parashikuar me ligj në çdo vend ku operojnë. Pothuajse asnjë prej tyre nuk garanton pagë jetese në praktikë. Paga minimale e parashikuar në ligj është ajo që punëtorët e veshjeve zakonisht marrin - ndonjëherë edhe më poshtë këtij niveli. Ndërkohë, qeveritë në rajonet prodhuese, si në Evropën Qendrore-Lindore-Juglindore, i mbajnë pagat minimale sa më të ulëta që të jetë e mundur, mesatarisht sa një e katërta e nivelit minimal të jetesës, duke i krahasuar pagat vazhdimisht me vendet konkurruese dhe duke pasur parasysh rrezikun se markat mund të vendosin që t'i porosisin produktet në vende të tjera. Kërcënimi i zhvendosjes së markave përbën një pengesë madhore në negociimin e pagave, si dhe një pengesë shumë të madhe për një krah pune të organizuar.


Prodhuar në Evropë - prodhuar ndershmërisht?

Duket se ekziston gjerësisht perceptimi se kushtet e punës dhe pagat në prodhimin evropian të modës janë më të mira sesa në Azi. Në fakt hendeku mes pagës minimale dhe pagës reale të punëtorëve dhe një page jetese minimale e llogaritur është e prirur të jetë më i madh në Evropë sesa në Azi. Në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore konstatojmë një nivel krahasimisht të ulët sindikatash në përgjithësi dhe veçanërisht në industrinë e veshjeve.

Pagat minimale janë, mesatarisht, ekuivalente me 25% të pagës Evropiane dysheme		
PAGA MINIMALE		Paga Evropiane Dysheme

Pagat minimale janë, mesatarisht, ekuivalente me dy të tretat e kufirit të varfërisë së BE-së	paga minimale e parashikuar në ligj	kufiri i varfërisë
PAGA MINIMALE		

ZBËRTHIMI I KOSTOS SË NJË BLUZE



Paguani punëtorët me

PAGË JETESE

Ata duhet të jenë në gjendje të përballojnë:

ushqimin

qeranë

kujdesin shëndetësor

arsiminin

rrobat

transportin

kursimet

Paga e jetesës është një e drejtë njerëzore, për të GJITHË njerëzit, në të GJITHË botën

Ndërsa paga e jetesës është thjesht një kategori e bazuar në nevoja dhe kosto të jetesës, paga minimale ligjore është një sasi e negociuar politikisht. Paga minimale ligjore tani nuk i mbron punëtorët nga varfëria.

Cilat janë karakteristikat kryesore dhe të gjithëpranuara të pagës së jetesës?


- a. Si një e drejtë universale e njeriut, ajo vlen për të gjithë punëtorët, pavarësisht statusit të tyre në vendin e punës, produktivitetit apo situatës së tyre personale (p.sh. gjendja civile). Është paga më e ulët e paguar dhe asnjë punëtor nuk duhet të paguhet më pak sesa paga e përcaktuar e jetesës.
- b. Ajo duhet të jetë gjithmonë e mjaftueshme për plotësimin e nevojave bazë të punëtorëve, duke përfshirë ushqimin, strehimin, transportin publik, shërbimet dhe komunikimin, arsimimin, kohën e lirë dhe kulturën, kostot e shëndetit dhe higjenës dhe pushimet (një javë brenda vendit)
- c. dhe ato të familjeve të tyre, të cilat tejkalojnë thjesht mbijetesën, por mundësojnë pjesëmarrjen e familjes në jetën shoqërore.
- d. Një pagë jetese duhet të sigurojë të ardhura specifike për raste urgjente.
- e. ajo duhet të fitohet gjatë orarit normal të punës, d.m.th. pa llogaritur orët e punës jashtë orarit.

Pse duhet që pika e referimit e pagës së jetesës të jetë ndërkufitare?

Cili është ndryshimi kryesor në vlerësimet ekzistuese të pagës së jetesës (LW)? Modeli global i biznesit të modës pë masën krijon nevojën për një politikë që lufton konkurrencën e zhvendosjes midis vendeve / rajoneve rreth pagave. Politikat e njëanshme dhe të bazuara në rregulla kombëtare për trajtimin e çështjes rezikojnë të bien në grackën e 'avantazhit konkurrues' dhe kështu të mos arrijnë të sfidojnë spiralen në rënie që ata u përpoqën të sfidonin që në fillim. Ato duhet të plotësohen me politika ndërkufitare.

Përmes konceptit tonë për një pagë jetese bazë ndërkufitare, ne synojmë të intensifikojmë betejat urgjente për pagat e jetesës dhe të mbështesim fuqinë e negociatave të sindikatave. Ne synojmë të arrijmë një jetë të denjë për punëtorët në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore.

Standardi perfekt?
Por kjo nuk do të thotë që Paga Dysheme e Evropës është vlerësimi i vetëm i mundshëm. Përkundrazi: standardet ndërkufitare dhe kombëtare të pagave të jetesës plotësojnë njëra-tjetrën. Ne jemi duke shmangur grackën e kërkimit të vlerësimit perfekt të pagës pasi një gjë e tillë nuk ekziston. Standardi referues i propozuar që CCC-ja sjell nuk ka për qëllim të përjashtojë hapësirën e politikave për devijime. Mund të përshtatet më tej nga sindikatat në vende të ndryshme, bazuar në nevojat dhe kontekstet e tyre.



Rruga përpara

1

Markat e modës dhe shitësit me pakicë duhet të ndërmarrin hapa publikë, konkretë dhe të matshëm për të gjithë zinxhirin e tyre të furnizimit për të siguruar që punëtorëve të veshjeve t'u paguhet paga e jetesës brenda një afati kohor të arsyeshëm. Markat e modës dhe shitësit me pakicë duhet të negociojnë